



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 159/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Zyhdë Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega Gjilan, për shkak të vendosjes së tendës dhe një tavolinë mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa Anr.159/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Gjilan, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e një tende dhe një tavoline ndër tendë me materiale propaganduese, në sheshin “Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha” në qytetin e Gjilanit, i shqiptohet gjobë në vlerë prej 3,000.00 (tremijë) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 01.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.159/2019, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Gjilan, me të cilën pretendohet se ka vërejtur një shkelje vendosjen e një tende dhe një tavoline ndër tendë me materiale propaganduese, në sheshin “Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha” në qytetin e Gjilanit. Paraqitësi i ankesës më tutje thekson se subjekti politik LDK, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, perkatësisht nenin 33 pika b), dhe me Rregullat zgjedhore 13/2013. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tyre, ankesës së paraqitur i kanë bashkangjitur tri fotografi për rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 02.10.2019, ka theksuar se vendosja është bërë për faktin se komuna nuk ka arritur që, ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, të krijojë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore. Më tutje subjekti politik (LDK), deklaroi se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 2, të LZP-së, gjeti se: **Ankesat është e pa bazuara, për këto arsye:**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë Tenda, dhe një tavolinë ndër tendë me material propagandues në sheshin “Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha” Gjilan, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b), të LZP-së, e cila

përcakton: “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”.

Duke u nisur nga gjendja faktike mbi ngritjen e tendave, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është shkelur neni 33 pika b), të LZP-së, pasi që Tenda, dhe një tavolinë ndër tendë me material propagandues, është vendosur mbi rrugët publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjohës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me Rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti Tenda, dhe një tavolinë ndër tendë me material propagandues është vendosur mbi rrugë publike.

Si rrethanë PZAP-i, morri edhe faktin që subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë, ka deklaruar se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në uljen e gjohës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1, pika c) dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.159/2019 më datë 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.